



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.06.2015 me fillim në ora 10.15, në sallën e KK-së. Të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Idriz Vehapi, Nënkryetari drejtorët e drejtorive, delegatët, përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, mediat dhe të tjerë. Mbledhjen e ka kryesuar **Nahit Elshani – kryesues i Kuvendit**, i cili në fillim ka përshëndetur të pranishmit, ka konstatuar se ekziston forumi i mjaftueshëm për nxjerrjen e vendimeve të plotfuqishme dhe për mbledhjen e sotme ka propozuar këtë:

Rend Dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2016-2018,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik dhe iniciimin e procedurës së shpronësimit për zgjerimin e oborrit të shkollës “Haki Stërmilli” Zoçisht.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për hyrje në marrëveshje kontraktuale me kompaninë Daneze HeSaLight për investim në ndriçim publik,
7. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj që pika e 6 e rendit të ditës të shtyhet në një nga mbledhjet e radhës pasi që ka nevojë për disa konsulta shtesë.

Fatmir Iska – Ne në KPF jemi mare vesh që si pikë shtesë të jetë edhe raporti i punës së KF “Rahovecit”, ndërsa sot nuk pe shoh këtu si material të shpërndarë dhe si pikë shtesë.

Kryesuesi - Ky material nuk i ka ndjek procedurat, nuk ka shkuar përmes Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, prandaj i është kthyer Drejtorisë që ajo ta përgatitë për KPF, besoj se në mbledhjen e korrikut do jetë.

Bahtjar Hoti –Kryetari e tha se shtyrja e kësaj pike do të bëhet sepse ka nevojë për disa konsulta, konsulta me kompaninë Daneze apo tjera konsulta sepse si material këtu është shumë mirë e detajuar.

Kryetari – Konsultë ka të bëjë me çështje të prokurimit e jo me kompaninë Daneze.

Kryesuesi - E qes në aprovim kërkesën e Kryetarit që të hiqet pika 6 prej rendit të ditës dhe të lihet për një mbledhje të radhës. Konstatoj se unanimisht është aprovuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

E qesë rendin e ditës në aprovim pa pikën e 6-të. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Procesverbali aprovohet pa vërejtje.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2016 – 2018.

Lulzim Sylejmani – Në bazë të Qarkores 2016/1 buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2016 është në limitet prej 11,362,254.00 €. Ky buxhet ka pësuar ndryshime në Grandin e Përgjithshëm, të Arsimit dhe të Shëndetësisë, njëkohësisht ka pësuar ndryshim sa i përket të hyrave vetanake për vitin 2016. Grandi i Përgjithshëm ka një zvogëlim në krahasim me vitin e kaluar në vlerën 324,381.00 €, ndërsa Grandi i Arsimit ka një rritje në krahasim me vitin 2015 në vlerën 453,335.00 €. Grandi i Shëndetësisë vazhdon të mbetet i njëjte për vitin 2016, ndërsa të hyrat vetanake në krahasim me vitin 2015 janë të rritura në planifikim për vlerën 59,000.00 €. Nëse e marrim si tërësi këtë buxhet për vitin 2016 kemi një ndryshim dhe zvogëlim për vlerën 76,447.00 €. Nga kjo qarkore në bazë të vlerave dhe kalkulimeve që i kemi nxjerr do të del që investimet kapitale në vitin e ardhshëm do të zvogëlohen dukshëm, për shkak se buxheti i vitit 2016 merr një shumë të konsiderueshme nga grandet për mbulimin e rritjes së pagave. Kështu që disa nga prioritetet që kemi planifikuar të realizohen në vitin 2016 do të shtyhen për vitin 2017. Në ndërtimin e KAB për vitet 2016 – 2018 për Komunën e Rahovecit ka këtë përmbytje: strategjia zhvillimore komunale, deklarata e prioriteteve të cilat prioritete dalin nga korniza afatmesme e shpenzimeve që është në nivel kombëtar, korniza fiskale, korniza makro ekonomike, tendencat e të hyrave vetanake dhe parashikimi 2016 – 2018, planifikimi komunal i bashkëfinancimeve sektoriale me ministrinë e linjës dhe financimi i jashtëm, politikat e reja, shpenzimet komunale të parashikuara 2016 – 2018, dhe në bazë të sugjerimeve dhe trajnimeve që kemi pasur e kemi futur edhe analizën gjinore që të kemi një pasqyrë për buxhetin e përgjithshëm gjinor në bazë të ligjit për të drejtat dhe barazi gjinore. Disa nga prioritet janë ranguar këtu edhe nga MSA-ja të cilët Qeveria i ka futur në KASH-in e vet dhe ne si komuna duhet patjetër që ti përfshijmë në KAB. Prej prioriteteve që i kemi vendosur në KAB janë: Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë, përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, përmirësimi i ambientit komunal dhe qëndrueshmëria e

tij, krijimi i qeveris komunale që ofron shërbime efikase që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe rini, kulturë dhe sport. Sa i përket politikave të reja ne duhet të bazohem në KASH-in në nivel shtetëror, ku paralajmërimet janë që në vitet e ardhshme grandit i përgjithshëm që ndahet nga MF do të pësojë zvogëlim. Njëkohësisht tendenca është që të hyrat komunale të rriten në vazhdim dhe të hyrat vetanake të bartin një pjesë të obligimeve buxhetore. Tek mallrat dhe shërbimet kemi një rritje të vazhdueshme që kërkohej për shkak se kemi shpenzime të reja, mirëmbajtja e rrugëve, shkollave, pastrimi i rrugëve, ndriçimit publik dhe çdo ndërtim të ri që është duke u bërë, pra këtu kemi vazhdimësi kërkesa për rritje të këtyre shpenzimeve. Ndërsa nga MF tentimi është që të zvogëlohen mallrat dhe shërbimet. Vitin e kaluar kemi pas një zvogëlim prej 15% ka mundësi reale që gjatë rishikimit të kemi edhe këtë vit zbritje në mallra dhe shërbime. Sa i përket shpërndarjes në kategori nëpër drejtori nuk mundemi ta bëjmë pa ardhur qarkorja e dytë buxhetore sepse nuk i dimë ende kufijtë e saktë buxhetor.

Flori Boshnjaku – E falënderoj drejtorin për sqarimin që e dha, por kam disa pyetje, tek analiza gjinore mendoj se kur të bëhen projektet duhet të jenë edhe për barazi gjinore. Komunitet tjerë kanë filluar, është mirë që edhe Komuna e Rahovecit të fillojë. Tek faqja numër 4 asistencë sociale për fëmijët në nevojë pa të ardhura, mendoj se kjo është kompetencë e MPMS e jo e komunës, a është bërë ndonjë lëshim apo keni pas qëllim që t'i ndihmoni në bazë të subvencioneve. Tek buxheti për shëndetësi dhe arsim, në arsim e pashë se ka shtesë mbi 400,000.00 € ndërsa në shëndetësi është buxheti i njëjtë. Pyetja ime është: rritja e buxhetit në arsim a është për shkak të rritjes së pagave sepse edhe në shëndetësi janë rritë pagat ndërsa buxheti është i njëjtë.

Afrim Limani – Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2016 në bazë të ligjeve të specifikuar nga MF është ma i vogël në krahasim me vitin e kaluar. Në total ky buxhet nuk është me ndonjë ndryshim të madh nëse i fusim edhe të hyrat vetanake dhe në total buxheti i komunës sonë është për 76,000.00 € ma i vogël. Fatkeqësisht ma e madhe është se investimet kapitale janë zvogëluar për 481,000.00 €. Në bazë të këtyre investimeve që i bije një mesatare prej 58.00 € për kokë banori, çka mund të presim në ndonjë zhvillim ekonomik duke e ditë se komuna jonë ende nuk i ka plotësuar nevojat elementare për qytetarë. Faji nuk është i yni sepse këto janë të përcaktuara nga MF në bazë të 10 % të planit të përgjithshëm që është ndarë. Desha ta sugjeroj drejtorin kategoria Mallra dhe Shërbime është e njëjtë ndërsa shpenzimet komunale janë zvogëluar për 24,500.00 €. Propozoj që të rriten shpenzimet komunale edhe për 15,000.00 € dhe të zvogëlohet kategoria Mallra dhe Shërbime, sepse kjo kategori është e ndjeshme. Po ashtu edhe mu më habit se Grandi i përgjithshëm për shëndetësi është i njëjtë, si ka mundur të jetë i njëjtë kur kemi rritje në pozicionin e pagave.

Rukije Krasniqi – Pyetja ime për drejtorin është për KAB-in 2016 cila ishte specifika e zvogëlimit për vitin 2016 për sa përqindje dhe cilat sektorë i prek ma tepër.

Lulzim Sylejmani – Përgjigje Florijes. Sa i përket asaj pike është menduar për ndihmë sociale personave nga subvencionet, por në pika të trasha këtë model sivjet gjitha komunitet e kanë pranuar nga USAID dhe ka mbetë aty, përndryshe ne do ta korrigjojmë. Sa i përket buxhetit të Arsimit dhe Shëndetësisë pse nuk është zvogëluar, ju e dini se grandit i arsimit çdo vit për investime kapitale ndihmohet nga grandit i përgjithshëm, përndryshe këtë buxhet që jeni duke e parë është vetëm për paga, ndërsa grandit i shëndetësisë i ka pas edhe investimet kapitale të vetat. Në këtë vit grandit i shëndetësisë do i mbulojë pagat, por do të zvogëlohen investimet kapitale gati gjysmë milionit, nuk është vetëm për komunën tonë por në nivel të gjitha komunave në Kosovë. Afrimi pyeti për zvogëlimin e shpenzimeve komunale. Shpenzimet komunale janë zvogëluar sepse me marrëveshjen e bërë me kompaninë RADONIQI pagesën e ujit të pompave i ka kaluar atyre, në kemi pas një shpenzim në këtë vit për ujin e pompave gati 25,000.00 € deri në muajin e 6, pra kjo vlerë është zvogëluar tek mallrat dhe shërbimet përndryshe shpenzimet tjera në komunalit nuk do të mbesin të rrezikuara nga ky zvogëlim.

Kryesuesi - E qes në aprovim KAB-in 2016- 2018: konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar KAB-i 2016 – 2018.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale.

Fehmi Hoxha - Rregullorja për dhënien e lejes Mjedisore Komunale me hyrjen në fuqi të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha kanë lindë si nevojë të bëhet Rregullorja e re për Dhënie të Lejes Mjedisore Komunale, sepse neni 29 i Rregullores për Taksa Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha me nr 01 1076 të datës 27.03.2015 e shfuqizon në tërësi rregulloren e mëhershme për dhënien e lejes mjedisore komunale me nr. 1849 të datës 30.04.2013. Rregullorja për dhënien e Lejeve mjedisore komunale ka për qëllim parandalimin e ndikimit negativ të mjedisit që mund të shkaktohet nga subjektet publike apo private me rastin e realizimit të veprimtarive dhe projekteve përkatëse të cilat mund të shkaktojnë çrregullimin në mjedis. Rregullorja në fjalë përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin, vlerësimin raportin e ndikimit në mjedis dhe procedurat administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga autoriteti komunal për lëshimin e lejes mjedisore. Aplikimi për marrjen e lejes mjedisore bëhet krahas zhvillimit të procedurave për marrjen e lejes ndërtimore. Leja mjedisore komunale lëshohet për periudhën 10 vjeçare duke u mbështetur në nenin 10 të udhëzimit administrativ 10/2012 dhe mundësia e vazhdimit të lejes mjedisore parashihen në nenin 13 të po këtij udhëzimi. Kjo projekt rregullore i ka

kaluar të gjitha procedurat nga KPF, Kuvendi paraprak si dhe në fund është mbajtur edhe debati publik me qytetar me datën 17.06.2015. Nuk ka pas ndonjë propozim konkret për ndryshim, prandaj ju ftoj që me votën tuaj ta miratoni këtë rregullore.

Florije Boshnjaku – Kam një pyetje tek neni 18 faqe numër 9 pika 3, dënim me gjobë në të holla prej 500–5000 €, a kishte me pasë mundësi që të caktohet një shumë tjetër sepse lejohet të ketë manovrime me shumën prej 500–5000 € nëse nuk është e caktuar me ligj ose udhëzim administrativ. Unë propozoj të jetë nga 3000–5000 € ose ndonjë shumë tjetër. Tek neni 26 ku thuhet se rregullorja hynë në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e kuvendit, ne jemi mare vesh që të jetë 15 ditë minimumi.

Selim Duraku – Neni 17 dhe 18 ku thuhet: kur nuk jepen të dhënat e sakta dënimi është deri në 10,000.00 €, ndërsa personat që nuk e regjistrojnë fare lejen mjedisore komunale dënimi është 250 €. Pra, më mirë qenka sipas kësaj rregullore mos me regjistrua fare këtë leje mjedisore se sa me e regjistrua.

Fatmir Iska – Ne e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar këtë rregullore, por e shoh se nuk janë inkorporuar rekomandimet tona, por më e keqja është që nuk janë përmirësuar as gabimet teknike që i kemi cekë. Në nenin 10 jemi pajtuar që të përcaktohet se kush i heqë shpenzime personi fizik, juridik apo komuna. Tek nenet 23 dhe 24 kapitulli zgjidhje e kontesteve nuk janë përmirësuar fare.

Kadri Dellova – Drejtori e tha se e kemi pas lejen e vjetër mjedisore, dua ta di se me lejen e vjetër mjedisore sa operator shkatërrues të mjedisit janë dënuar. Kam pas rast të dal një dit tek lumi i bardh me disa koleg dhe më besoni se kur shkatërrim ma të madh nuk ka pas mjedisi se sa këtë vit, duke filluar që nga nxjerrja e zhavorrit dhe mbeturinave të ngurta, të gjitha restorantet që funksionojnë në Xërxë janë duke hedhur mbeturina në Drinin e Bardh. Pra ne sot duam të aprovojme lejen e re mjedisore por unë kam pyetje se a ka funksionuar leja e vjetër deri më tani. Ka ardhur kohe ti themi stop shkatërrimit të mjedisit dhe njerëzit që e shkatërrojnë mjedisin të marrin dënimin e merituar.

Rukije Krasniqi – Unë do i përgjigjem Kadriut që e tha se sa punime pa leje janë shkaktuar. Punimet pa leje janë shkatërruar vetëm atyre personave që nuk janë në PDK, ndërsa ata që janë në PDK nuk kanë leje fare dhe shpresojmë se pajisen ndonjëherë.

Fehmi Hoxha – Znj. Florije neni 17 që është 5000 – 10.000 € është e përcaktuar me udhëzimin administrativ dhe me ligj, pra kjo nuk mund të ndryshohet. Neni 18 pika 3 propozimi është 500–5000 € që do të thotë këtu ka mundësi të zvogëlohet, ajo ju mbetet juve si të vendosni. Neni 26 është bërë gabim, duhet të jetë 15 ditë dhe jo 8, kjo të përmirësohet. Selimi e ceku që më mirë i bie atij që nuk ka leje fare mjedisore se ai që ka dhe ka dhënë shifra gabim, nuk është ashtu sepse ai që nuk e regjistron në fillim gjobitet me 250 € dhe obligohet përsëri të pajiset dhe do ti nënshtrohet procedurës komplet, pra do të ketë dy dënime.

Bahtjar Hoti – Unë mendoj se duhet të bëhet gjobitja në bazë të vlerësimit të ndotjes dhe është shumë në rregull shifra prej 500 € – 5000 € sepse nuk ka logjikë nëse ka bërë dikush një ndotje të vogël të gjobitet me gjobë më të vogël prej 3000 €.

Kryesuesi – E kisha lutë zyrën ligjore që ato vërejtje që i patë Fatmiri të përmirësohen. E qesë në aprovim Rregulloren për leje mjedisore komunale: konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rregullorja për leje mjedisore komunale.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

Avdullah Kryeziu – Ky Propozim Vendim ka kaluar edhe në KPF ku anëtarët e KPF kanë pasur disa vërejtje rreth afatit të dhënies së këtyre 5 kamp shtëpizave që gjinden në fshatin Xërxë, kanë kërkuar që afati i dhënies së këtyre 5 kamp shtëpizave të lidhet me afatin e restorantit tek Ura e shenjtë. Restoranti është dhënë në qershor të vitit 2013 dhe afati si skadimit është edhe 13 vite. Pra, afati për dhënien e këtyre 5 kamp shtëpizave në fillim ka qenë propozimi për 5 vite ndërsa është bërë një përmirësim dhe tash është 13 vite, pra është lidh me afatin e skadimit të restorantit. Këto kam shtëpiza më parë kanë pas kontratë dhe kontrata e tyre ka skaduar në vitin 2013. Kryetari i komunës me propozimin e drejtorisë ka formuar një komision për verifikimin e këtyre kamp shtëpizave, të shohim një herr se në çfarë gjendje janë. Qiramarrësi i mëparshëm ka pasur për detyrë që të investoj në këto 5 kamp shtëpiza, por unë nuk kam kurrfarë raporti nga qeverisjet e mëparshme. Janë 5 kamp shtëpiza, i kanë 80 m², çmimi i mëparshëm ka qenë 0.40 cent për m², qiraja mujore 160 €. Shuma e paguar e qirasë është konform kontratës dhe operatori i ka paguar gjithsej deri në përfundim të kontratës 19,200.00 €.

Rasim Fazliu – Edhe në KPF e kam dhanë mendimin tim që është shqetësuese se si kalojnë kontratat që janë të lidhura dhe nuk kontrollohen me kohë, pra kam një propozim për gjithë drejtorët e ekzekutivët që herrave tjera le ti kontrollojnë mirë kontratat dhe mos të lejohen kësi raste. Sa i përket zgjatjes së afatit edhe unë akordohem që kjo të lidhet me zgjatjen e kontratës sa e ka restoranti, pra jam për që të jetë 13 vite në mënyrë që pas 13 viteve të jepet edhe restoranti edhe kamp shtëpizat së bashku me një ankand.

Qazim Qeska – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, dua një sqarim nga drejtori sa i përket çështjes se çka jepet këtu me qira dhe shfrytëzim, ka një ngatërresë në pikën 1 dhe 2 sepse cekët që jepet parcela kadastrale por

duhet të dimë se kjo parcelë i ka gati 3 hektar sipërfaqe, duhet që të mos ngatërrohem që kur ti jepet nesër në shfrytëzim atij të i jepet përpos kam shtëpiza edhe terr parcela që është afër 3 hektar. Pra duhet të precizohet kjo çështje dhe të jepet vetëm pjesa e parcelës në të cilat janë të ndërtuara këto kam shtëpizat sepse pjesa tjetër me vendimin e ish Kuvendit të Komunës së Rahovecit është nën mbrojtjen kulturore vendi që është akoma në fuqi.

Florijs Boshnjaku - Pajtohem plotësisht me kolegun Qazimin kur e tha se duhet të precizohet qartë se çka jepet. Po ashtu propozoj që ky kuvend të caktoj shumën minimale për aplikim në ankand publik nëse nuk është e caktuar me rregullore.

Avdullah Kryeziu – unë këtë kontratë nuk e kam gjetë në sirtarët e Drejtorisë për ekonomi është dashur që vet të shkoj tek qiramarrësi i këtyre kamp shtëpizave dhe t'i kërkoj atij kontratën dhe atëherë e kam parë që i ka skaduar kontrata. Sa i përket pyetjes së z. Qeska komisioni për dhënie në ankand publik do i precizon kriteret dhe aty do të cekët se jepen vetëm 5 kamp shtëpizat dhe po ashtu mundet të cek edhe pjesën e shfrytëzimit të jashtëm. Sa i përket shumës që e tha Znj. Florijs, komisioni që është i formuar nga kuvendi është kompetent për caktimin e shumës.

Ejup Kabashi – Atëherë kur e kemi dhanë në ankand publik ne e kemi pas një pikënisje se çfarë limiti ka fillimi dhe në kuvend ashtu është aprovuar, të kemi të qartë sepse rregullorja e thotë se hapësirat publike nën 2 € nuk jepen dhe plotësisht pajtohem me kolegun Qazim s edhe hapësira të përcaktohet sepse vetë objektet që janë aty duhet të kenë qasja diku.

Kadri Dellova – Edhe unë pajtohem me parafolësin sepse kjo mundet të sjellë në të ardhmen probleme. Çka nëse operatori i mëparshëm nuk e fiton të drejtën që ti merr këto në pronësi këto 5 kamp shtëpiza sepse parkingu që është aty para kamp shtëpizave është duke e shfrytëzuar ai për restorant dhe pa këtë parking këto kam shtëpiza janë jo funksionale. Propozoj që ky vendim të shtyhet për një seancë tjetër dhe të qitet në ankand publik edhe kam shtëpizat edhe prona dhe hapësira që është aty.

Fatmir Iska - Pronari aktual që po e shfrytëzon restorantin e ka edhe pjesën e parkingut në shfrytëzim, hipotetikisht po e them nesër nëse e fiton dikush tjetër në ankand ku do të sigurohet hyrja për në këto 5 kamp shtëpiza ku e dimë se aty janë vetëm disa shkallë për këmbësor. Po ashtu është mirë që të precizohet qartë hapësira e jashtme e kamp shtëpizave, mendoj se përpos shfrytëzuesit aktual askush nuk ka interes me i mare në shfrytëzim këto 5 kamp shtëpiza meqenëse e shfrytëzon edhe parkingun.

Bahtjar Hoti – Mendoj se paraprakisht është përcaktuar ky lokacion se kujt ti jepen këto 5 kamp shtëpiza duke e bërë afatin e njëjtë me të restorantit pra unë mendoj se e ka një orientim, pse ne nuk po diskutojmë që të shkoj si paket edhe restoranti edhe kamp shtëpizat por ndaras.

Kryesuesi - Drejtor ne në KPF kemi kërkuar që sot të na vije një vlerësim nga komisioni ju ende nuk e keni vlerësimin e komisionit dhe unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës kur të vije vlerësimi i komisionit dhe përmirësimi i këtyre vërejtjeve që i dhanë delegatët.

Nënkryetar – E shoh se gatishmëria e juaj është që të shtyjeni këtë pikë për mbledhjen e ardhme. Shumë me vende ishin pyetjet e kuvendarëve se a po japim hapësirë fushore apo objektin me m², do të përkufizohet se sa do të jetë oborri dhe sa është parkingu. Mundeni të shtyjeni ju por nuk ka asgjë më tepër se sa që mundet me punu komisioni në bazë të pikave që i ka ligji mbi dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe as kuvendi dhe as komisioni nuk mundet të shkoj ma tutje, është e vërtet se para se të dal në ankand duhet të përcaktohet shuma minimale a përcaktohet nga kuvendi apo nga komisioni ajo ka pak rëndësi.

Rasim Fazliu – Unë pajtohem me Kryesuesin kur e tha se komisioni duhet së pari të bëjë vlerësimin të pastaj të caktohet vlera minimale dhe të përkufizohet edhe pjesa e terrenit të cilën do ta shfrytëzojnë këto 5 kamp shtëpiza. Propozoj që komisioni të del para kuvendit me të gjitha këto të dhëna e pastaj ne si kuvend nëse kemi diçka për të shtuar ose për të propozuar do propozojmë.

Fatmir Iska – Pajtohem me parafolësin dhe në emër të këshilltarëve të AAK-së ne jemi për me e shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të kemi informata shitesë.

Kadri Dellova – Ne duhet të jemi të vetishëm dhe po supozojmë se nëse e fiton operatori tjetër këto 5 kamp shtëpiza besoni se me parking do jetë problem se kush duhet të jetë titullar i pronës.

Kryesuesi – Kush është që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhme: Konstatohet se në mënyrë unanime është votuar që të shtyhet pika e 4 për mbledhjen e ardhshme.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik dhe iniciimin e procedurës së shpronësimit për zgjerimin e oborrit të shkollës “Haki Stërmilli” - Zoqisht.

Kujtim Popaj – Përshëndetje për të gjithë, kjo pikë është shqyrtuar edhe në KPF është një propozim i Kryetarit të komunës për shpallje të interesit të përgjithshëm të kësaj parcele, parcela gjendet në fshatin Retijë me nr. kadastrë 321/0 me një sipërfaqe 18 ari e 17 m², kjo sipërfaqe do të shfrytëzohet për nevojat e shkollës “Haki Stërmilli” në Retijë që është paralele e ndarë e shkollës filllore në Zoqisht. Arsyeja e shpronësimit të kësaj parcele është zgjerimi i oborrit të kësaj shkolle për zhvillimin e aktiviteteve sportive sepse hapësira e gjertanishme ku gjendet shkolla nuk ka mjaftuar për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Kjo pronë është pronë private e një qytetari

po nga ky fshat me emrin Voislav Terpkoviç, pas aprovimit të këtij propozim vendimi nga ana juaj ne do të vazhdojmë me ndjekjen e procedurave sipas ligjit mbi shpronësimin e pronave.

Rasim Fazliu – Kjo pikë është shqyrtuar edhe në KPF dhe është mirë që shkollave në territorin e komunës sonë të ju lejojmë hapësirë që të zhvillojnë të gjitha aktivitetet sportive. Personalisht e kam qenë në këtë shkollë dhe me të vërtet ka një hapësirë shumë të vogël kjo shkollë. Nëse komuna ka mundësi buxhetore është mirë që të bëhet shpronësimi i kësaj parcele në mënyrë që kjo shkollë të ketë oborr të mjaftueshëm. Ne si grupe do ta përkrahim dhe do ta mbështesim këtë pik të rendit të ditës.

Florije Boshnjaku – Secili prej nesh pajtohem që të zgjerohen oborret e shkollave, por nuk jam duke e parë kërkesën e Drejtorisë së Arsimit dhe as arsyeshmërin, sa nxënës i ka kjo shkollë, sa është sipërfaqja e oborrit të shkollës dhe sa sipërfaqe kërkohet, po ashtu nuk jemi të njohur se sa kushton shpronësimi i kësaj parcele dhe a ka komuna mjete për shpronësim të kësaj parcele. Nëse fillojmë më kësi lloj shpronësime besoni se duhet çdo rrugë ose çfarëdo kërkesë që na vije ne duhet që ti kompensojmë.

Ejup Kabashi – Fillimisht dua të arsyetoj këtë kërkesë për shpronësim sepse jam dëshmitar i kushteve që i ka ajo shkollë. Nuk dua të pyes për koston sepse sigurisht brenda ligjit për shpronësim edhe drejtoria do të veproj. Nxënësit e kësaj shkolle me të vërtet kanë nevojë për kushte ma të mira dhe për një teren sportiv, prandaj ne si kuvendarë duhet ta përkrahim dhe ti japim dritën jeshile këtij propozimi vendimi dhe të bëhet shpronësimi i kësaj parcele në bazë të ligjeve të shpronësimit që janë në fuqi.

Fatmir Iska – Ne jemi për zgjerim të hapësirave të shkollave dhe oborreve të shkollave po nuk jemi që të bëhet në këtë formë. Kjo shkollë mundet ti ketë afërsisht 50 nxënës me dy ndërrime janë pak duke marr parasysh raportin e Drejtorisë së Arsimit ku numri i nxënësve dita e ditës zvogëlohet jo vetëm në këtë shkollë por në gjithë shkollat e komunës. E kam potencuar edhe në KPF e kemi shkollën “Bekim Sylka” që është përball komunës hiq ma tepër se kjo shkollë nuk ka hapësirë. A ka biseduar dikush me pronarin e kësaj parcele sepse ndoshta ai ka plane të tjera me këtë parcelë dhe a ka mjete komuna për këtë shpronësim, sepse ne kemi mare edhe një vendim për shpronësim tek shkolla “Ardhmëria” që gjendet në lagjen e epërme. Neni 2 thotë në këtë parcelë ekziston objekti shkollor por në mungesë të hapësirës mungon fusha për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e nxënësve të kësaj shkolle. Mendoj se shumë ma mirë kishte me qenë që Drejtoria e Arsimit të investoj në këtë hapësirë aktuale që ka shkolla dhe nxënësit kishin mundur të shfrytëzojnë këtë hapësirë shumë të nevojshme dhe mos të merremi me shpronësime të kota. Vota ime do të jetë kundër për këto arsye që i ceka më lartë.

Kadri Dellova – Ne duhet të mësohemi të bëjmë edhe politika pragmatiste, kur është interesi i nxënësve të një shkolle pavarësisht se ajo shkollë a është në Retijë, në Rahovec apo Zatriq kushtet për proces edukativo arsimor duhet të jenë të barabarta, qoftë me 20 nxënës, 10 nxënës qoftë edhe me 1000 nxënës. Ne e kemi obligim edhe kushtetues edhe ligjor që fëmijëve tanë ti krijojmë kushte sa ma të mira dhe aq më tepër për nxënësit e Retijës, sepse Retija është e shenjtë për gjithë ne. Ju ftoj që të gjithë njëzëri ta votojmë këtë Propozim Vendim.

Selim Duraku – Personalisht edhe unë kam qenë në këtë shkollë dhe pjesa mbrapa që jeni duke e parë në orto foto nuk mundet të shfrytëzohet për asnjë aktivitet sportiv e gjitha që e shfrytëzon shkolla për aktivitete është kjo me nr kadastrë 321. Sa i përket çmimit nëse e krahasojmë me shpronësimin që e kemi bërë në Rahovec besoj se kjo do ketë një çmim ma të lirë.

Fatmir Iska – Profesori mundet ti jep konotacion ndarjes qytet fshat por nuk do të thotë se ne po pajtohem me mendimin e tij. Nuk e thash që jam kundër zgjerimit, por meqenëse ka pjesë të mjaftueshme dhe duke mare për bazë numrin e nxënësve që ka kjo shkollë unë propozova që të rregullohet ky teren sportiv dhe shumë ma lirë dhe ma mirë kishte me qen. Unë nuk jam që ti jepet konotacion ndarjes qytet fshat por prapë unë e respektoj mendimin e profesorit.

Kujtim Popaj – Florija pyeti për kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, ju që jeni anëtar të KPF zakonisht e merrni edhe propozimin e Kryetarit dhe këtu shkruan se miratohet propozim vendimi i Kryetarit me numër dhe besoj se kjo e mbulon edhe kërkesën e Drejtorisë së Arsimit. Pyetja tjetër ishte se a ka mjete komuna dhe sa do t kushtoj prona. Në lidhje me mjetet në kuadër të planifikimit të buxhetit për vitin 2015 që është aprovuar nga ana juaj vitin e kaluar janë parapa diku 90,000.00 € për shpronësimin e pronave. Çmimi sa do të kushtoj unë nuk e di sepse është një organ shpronësues nga Qeveria që vendos për çmim. Fatmiri pyeti se a është biseduar me pronarin e kësaj parcele. Unë nuk kam pas kontakte dhe nuk jam takuar me këtë pronar, por kjo është një kërkesë e këshillit të fshatit Retijë dhe ata kanë biseduar me këtë pronar.

Nënkryetari – Si iniciativë ka dalë nga këshilli i fshatit Retij, kërkesa e tyre është drejtuar Drejtorisë për Arsim dhe me anë të aprovimit nga Kryetari i Komunës e pastaj kjo kërkesë vjen në kuvend për shpallje të interesit të përgjithshëm të kësaj hapësire. Kur të shpallet nga kuvendi interes i përgjithshëm nuk pyetet më pronari i asaj toke a e jep apo nuk e jep.

Bahtjar Hoti – Meqenëse e ka iniciuar këshilli i fshatit këtë kërkesë, a e ka vërtetuar këshilli i fshatit se ky person a është pronar i vërtet, që mos të na del pastaj ndonjë problem sepse e dimë shumë mirë ne se si i kanë regjistruar ata pronat në kadastrë.

Kryesuesi – Unë nuk jam duke u pajtuar me atë që e tha Nënkrjetari se kur të shpallet interes i përgjithshëm nuk pyetet me pronari. Kërkoj nga ju që të aprovohet ky propozim vendim i Kryetarit, e qesë në votim: Me 1 votë kundër, 4 abstenime dhe 22 vota pro është aprovuar propozim vendimi i kryetarit për shpronësim të kësaj parcele për nevojat e shkollës fillore “Haki Stërmilli” në Retij.

6. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,

Florijs Boshnjaku – Do ta shpreh një shqetësim të kamotshëm të qytetarëve të komunës e sidomos të banesave në Rahovec rreth qenve endacak, besoni se është shumë shqetësuese dhe është problem shumë i madhe sa që kanë dashtë të vinë qytetarët edhe në komunë që të pyesin se çka është puna rreth këtyre qenve a ka ndonjë tender ose a do të ndërmerret ndonjë masë. Nëse ka nevojë ne si kuvend është mirë që ta ngritim këtë çështje në nivel të Kosovës që të ndryshoj kjo çështje deri sa nuk është bërë vonë.

Kryesuesi – Kjo pyetje ka qenë edhe në debat me qytetarë që është mbajtur. Problemi është se Komuna nuk mundet të zgjidh problemin e qenve endacak. Ne mundemi si komunë të zgjedhim problemin sot, por prapë i ke të nesërme që vinë nga komunat e tjera. Zgjidhja e vetme është që ky problem të zgjidhet në nivel Kosove. Kërkoj nga Nënkrjetari që në mbledhjen e ardhshme në pikën pyetjet dhe përgjigje të jenë prezent të gjithë drejtorët prezent në sallë.

Besnik Hoti – Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, është një shqetësim i bujqve nga fshati Ratkoc ku si pasojë e bllokimit të kanalizimit dhe që janë duke rrjedhur vazhdimisht shkaktën dëm të konsiderueshme në të mbjellat bujqësore. A është bërë diçka në lidhje me këtë sepse ata vazhdimisht kanë bërë kërkesa në drejtorin e caktuar.

Selim Duraku – Po ashtu edhe dua të ju përcjellë një shqetësim të qytetarëve, është bërë një marrëveshje në mes Kryetarit dhe kompanisë RADONIQII për 9 cent për një kub ujë dhe nëse e bëjmë një analizë dhe e shohim se sa familje janë në tërë komunën tonë i bije që mbi 20,000.00 € RADONIQI të përfitoj nga qytetarët. Dua një sqarim nga drejtori i shërbimeve publike ose nga nënkrjetari.

Fatmir Iska – Një pyetje për drejtorin e shërbimeve Publike, janë krijuar shumë gropa nëpër qytet nga shirat, por ka gropa që i krijon kompania e RADONIQIT i hapin dhe nuk i rregullojnë. Unë sa e di ne kemi një kontratë për mirëmbajtje të rrugëve dhe është mirë që të filloj t'i mirëmbaj rrugët. Pyetja tjetër është për nënkrjetarin meqenëse ka qenë kryetar i komisionit për emërtimin e rrugëve, ku ka mbetë kjo punë meqenëse ne kemi mare vendim para 6 muajve.

Kadri Dellova – Pyetja ime i drejtohet Drejtorisë së Arsimit. Siq e dini dy shkolla fillore në Komunën tonë “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël dhe shkolla “Bajram Curri” Krushe të Madhe që një vite nuk janë duke e marr materialin shkollor, sepse operatori ka qenë i papërgjegjshëm dhe nuk ju ka përmbajt kontratë. Letrën për printer e ka bërë me çmim 5 € ndërsa hartat i ka bërë me çmim 0.10 cent. Kërkoj nga drejtoria e arsimit ose të formoj një komision ose të ndërmerr masa që të ja ndërpres kontratën. Pyetja e dytë ka të bëjë me një interes të përgjithshëm, pra me çështjen e Silosit në Xërxë. Siq e dini në janar të këtij viti Kryeministri i Kosovës i ka bërë kërkesë AVUK që të hetohet cilësia e miellit të kësaj kompanie dhe këto ditë Komisioni Parlamentar i Kosovës në krye me Adem Saliajn kanë konstatuar se mielli është i dëmshëm dhe është miell që vije nga gruri i mykur nga vitet e 90-ta. Nga informatat që kam mare shumica e furrave si në qytet po ashtu edhe në fshat janë duke u furnizuar me këtë miell jo të shëndetshëm. Propozoj që të formohet një komision nga kuvendi ose ekzekutivi që të shkoj në Silos që të shoh se a ka ende stoqe të këtij gruri kancerogjen.

Kryesuesi – Besoj se këtë punë e ka komisioni parlamentar dhe do të ndërmerr masa sepse ne si komunë nuk e kemi as të drejtën dhe nuk kemi as kapacitet që të konstatojmë një gjendje të tillë.

Sinan Bajraktari – Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike për ujin e pijes për fshatrat Polluzhë dhe Guri i Kuq. Muajin e kaluar morëm vesh se Kryetari një pjesë të mjeteve ka ndarë për kompaninë RADONIQI dhe është kryer obligimi ndaj kësaj kompanie, ata është dashur vetëm që të fillojnë të punojnë në këtë drejtim, por deri më tani asgjë në këtë drejtim nuk është bërë.

Rasim Fazliu – Gjatë punimeve të kullimit të tokave që janë kryer në një pjesë të terrenit që ka qenë e paraparë në fshatin Celinë, operatori gjatë punimeve e ka dëmtuar një rrugë gjatë hekurudhave, e cila rrugë më parë është rregulluar nga ana e komunës ndërsa operatori nuk e ka rikthyer në gjendjen e mëparshme dhe qytetarët kanë ankesa sepse kanë vështirësi të shkojnë në arat e veta.

Azbi Gashi – A ka pas kritere të regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme, kam informata të sakta që nuk janë përfillur fare kriteret. Po ashtu kam një kërkesë që secili komitet që formohet anëtarët e këtyre komiteteve të kenë nga një vendim sepse janë duke u bërë shumë shkelje dhe nuk janë duke u paguar anëtarët e komisioneve me rregull, kam qenë në dy komisione dhe për asnjërin nuk më është paguar mëditja, këtë kërkesë e kam bërë edhe në mbledhjen e kaluar.

Luljete Kadiri – Kush është përgjegjës për ngecja në kompletimin e dokumentacioneve për përvojën e punës të punëtorëve shëndetësor, ku të gjithë punëtorët shëndetësor të komunave tjerë e kanë mare këtë kompensim kurse komuna jonë nuk e ka bërë këtë kompensim.

Astrit Thaqi – Në Fshatin Kramovik është ndërruar një gyp i ujit të pijes që është instaluar nga qeverisja e mëparshme dhe a kishte me pas mundësi ta dimë se cila kompani e ka pas tenderin më parë dhe a është marr ndonjë masë ndaj asaj kompanie, sepse për një kohë shumë të shkurtër ky gyp është zëvendësuar me një gyp tjetër dhe është dëmtuar buxheti i komunës.

Rukije Krasniqi – Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit, pse nuk janë duke u lidhur kontratat e punës konform licencës 5 vjeçare që e kemi. Kontratat e punës i kemi 1 vjeçare ndërsa licencën 5 vjeçare. Po ashtu ka disa gabime qoftë ato teknike ose të paqëllimita lidhur me informacionet nga zyra e informimit që janë duke u plasuar si në portale apo media lidhur me Majën e Shkodranit. Maja e Shkodranit është monument historik e jo vend turistik.

Bahtjar Hoti – Kompleksi memorial në Gradish ka filluar të plasarit, dua ta di a ka hequr dorë komuna për finalizimin e këtij kompleksi.

Kryesuesi – Azbi unë e di që ti vendimet i ke mare për komisionet që ke qenë, komitetet që janë formuar në fund ende nuk i kemi bërë vendimet besoj se shumë shpejtë do të bëhen dhe gjatë javës së ardhshme do i ftojme të gjitha këto komitete që të bëhen funksionale dhe të zgjedhin kryetarin e komitetit dhe zëvendësin. Tek çështja e mëditjeve është keqkuptuar udhëzimi administrativ sepse udhëzimi administrativ vlen vetëm për shërbyesit civilë, ndërsa delegatët për pjesëmarrje në mbledhje paguhet në bazë vendimit që e ka nxjerrë kuvendi komunal i Rahovecit. Në të ardhmen asnjë komision nuk do të paguhet nëse nuk raporton para kuvendit.

Fehmi Hoxha – Komuna nuk ka hequr dorë nga përfundimi i projektit të kompleksit të dëshmorëve në Gradish, por për të përfunduar duhen edhe 60,000.00 € ndërsa për sivjet komuna i ka vetëm 20,000.00 €. Operatorin e ekonomik e kemi thirr disa herë javën e kaluar më ka dërguar një emal që do të fillojnë me përfundimin. Rreth asaj plasaritje me siguri se do ta rregulloj sepse me kontratë e ka edhe mirëmbajtje 1 vjeçare.

Feim Fetoshi – Për qentë endacak nuk kam çka të shtoj asgjë më shumë se atë që e tha Kryesuesi. Besniku pyeti për problemet me kanalizim në fshatin Ratkoc, probleme me kanalizim ka në terr komunën ton por problemi në Ratkoc është se kanalizimi ka mbetur pa pranim teknik dhe problemi më kryesor është në një pusët që gjendet përfundi hekurudhës ne jemi në ngjarje edhe pse RADONIQI e ka në përgjegjësi sepse edhe inkason për mirëmbajtje të kanalizimit, ne si drejtori i kemi bërë presion dhe ata kanë dalë në vend të ngjarjes dy herr e kanë evidentuar problemin por duhet një makinë e posaçme për me evituar problemin. Sa i përket komisionit unë nuk e di se ku e ka mare këtë informatë sepse ne nuk e kemi parë të arsyeshme me dalë pa u evituar problemi. Selimi pyeti për tarifën që është 0.9 cent m3, tarifa prej 0.9 cent për m3 është që kompania RADONIQIT e ka këtë tarifë nga rregullatori për ujë në nivel qendror, por neve na mbetet që ti japim presion që shërbimet ti ketë ma të mira. Po ju informoj që çdo qytetar i cili nuk e ka kanalizimin duhet së bashku me kryetarin e fshatit ose lagjes që të lajmërohet në kompaninë e RADONIQIT që të lirohet nga taksa për kanalizim. Por në bazë të ligjeve dhe në bazë të rregullores komunale ai që nuk e ka kanalizimin duhet të ketë gropën septike. Fatmiri pyeti për gropat që janë formuar në qytet, është e vërtetë që janë bërë disa gropa në qytet por ma shumë ka në rrugën Sopniq – Fortesë por që nga sot kam konfirmimin se konsumatori do të del që ti merremtoj ato gropa. Sinani pyeti për ujin e pijes në Polluzhë, çështja e ujit të pijes në Polluzhë është pak e komplikuar ky projekt ka përfunduar në vitin 2012 – 2013 më e keqja e kësaj është se zyrtarisht është bërë pranimi teknik ende pa u provuar elementet se a janë duke punuar dhe zyrtarisht operatori është në rregull, e vetmja shpresë që na mbetet është se në kontratë është që gypat që janë vendos duhet të kenë një atest dhe prodhuesi duhet të jepe garanci 10 vjeçare, kjo pyetje ndërlihet edhe me pyetjen që e parashtrij Astriti, ndërsa firma që ka punuar këtë projekt quhet ANEKS nga Prizreni.

Nënkryetari – Fatmiri pyeti rreth emërimit të rrugëve, siç e din edhe Fatmiri me atë kur e kemi kryer pjesën e dytë kuvendi për së dyti e ka bërë një revidim ne i kemi dërguar MAPL-së dhe Agjensionit Kosovar për Kadastër, në ndër kohë mbasi i kanë kontrolluar kanë kërkuar Drejtorin e Urbanizmit që të kthehen të gjitha ato të dhëna në Excel, ne e kemi punuar në programin e Word sepse neve ashtu edhe na ka ardhur dhe gjitha këto janë kthyer në Word po ashtu edhe vendimi prapë ata i kanë mare. Një emal që na ka ardhur si mua ashtu edhe kryesuesit ata janë në negociata të ngushta me disa donatorë për të hyrë në përpilimin e tabelave, ata e kanë mare përsipër neve dhe disa komunave tjera që të na gjejnë donacione.

Fatmir Iska - Mos të iniciojë procedura ligjore, lexojeni procesverbalin ku ne kemi marr një vendim, unë jam hequr nga vendimi për pagesë të mëditjes nga komisioni për emërtimin e rrugëve, po flas për komisionin e kaluar dua ta di vetëm arsyen se pse.

Nënkryetari – Për pjesën e mëhershme deri sa ke qenë drejtor nuk do të ketë pagesë, sepse ne sapo biseduam nëse dikush është në një komision dhe ka punuar gjatë orarit të punës, nuk do të ketë pagesë, dhe paguhet vetëm nëse kanë punuar jashtë orarit të punës. Mbledhja ka përfunduar në ora 12.20.

Procesmbajtësi,
Fahredin Sharku

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 416 Më 30.06.2015
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Kryesuesi,
Nahit Elshani